

25 Nëntor 2014, Prizren

**THIRRJE PËR APLIKIM**  
**Profesionistë me angazhim të përkohshëm (konsulentë)**

OJQ EC Ma Ndryshe me seli në Prizren ka nisur zbatimin e projektit “Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren”. Në kuadër të këtij projekti, do të hartohen: një katalog i trashëgimisë kulturore të rajonit Jug; dhe pesë guida/pako turistike të rajonit të Prizrenit. Për hartimin e këtyre produkteve turistike, EC Ma Ndryshe do të përzgjedh një numër profesionistësh për angazhim të përkohshëm (1 deri 3 muaj). Pozitat për të cilat ju ftoj të aplikoni janë:

- Historian – 2 pozita,
- Redaktor (editor) – 2 pozita,
- Fotograf – 1 pozitë,
- Hulumtues – 1 pozitë.

*Detyrat dhe përgjegjësitë*

Secila pozitë e angazhimit (konsulencës) përmban detyra dhe përgjegjësi specifike, ndërsa konsulentët duhet të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e projektit. Këto janë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore për pozitat e ofruara (lista e plotë e detyrave dhe përgjegjësive do të jetë pjesë e kontratës së konsulencës):

- **Historianët:** krijimi i inventarit të monumenteve të trashëgimisë kulturore në rajonin Jug, përzgjedhja e monumenteve më të rëndësishme për t’u prezantuar në katalog, përgatitja e përshkrimeve për të gjitha monumentet që do të prezantohen në katalog, ofrimi i ndihmës profesionale për kapitujt e tjerë të katalogut, konsultimi i disa burimeve objektive për pasqyrim të paanshëm të të dhënave historike.
- **Redaktori i katalogut:** koordinim i punës së historianëve gjatë përpilimit të përshkrimeve të monumenteve, shndërrimi i narrativave historikë në tekste atraktive për turistët, përpilimi përfundimtar i katalogut të Jugut (hartimi i kapitujve të tjerë), koordinim i ngushtë me fotografimin, konsultimi i disa burimeve objektive për pasqyrim sa më të paanshëm të të dhënave në katalog.
- **Redaktori i guidave/pakove turistike:** bashkëpunim i ngushtë me redaktorin e katalogut dhe historianët në përzgjedhjen e teksteve që do të prezantohen në pesë guidat/pakot turistike, përpilimi përfundimtar i pesë guidave/pakove turistike të rajonit Jug, koordinim i punës së Hulumtuesit (shih më poshtë) për mbledhjen e të dhënave nga të gjitha komunat e rajonit, koordinim i ngushtë me fotografimin, konsultimi i disa burimeve objektive për pasqyrim të paanshëm të të dhënave në guida/pako.
- **Fotografi:** fotografimi dhe video incizimi i të gjitha monumenteve që do të prezantohen në katalogun e rajonit Jug, fotografimi i të gjitha atraksioneve të tjera kulturore, natyrore, dhe të tjera të cilat do të prezantohen në katalogun dhe pesë guidat/pakot turistike të rajonit Jug.
- **Hulumtuesi:** mbledhja e të dhënave nga gjashtë komunat e rajonit Jug mbi atraksionet turistike (trashëgimi kulturor, natyrë, kuzhinë, jetë e natës, hotelieritë, shtigjet, etj.), përpilimi i listës së gjerë të përmbajtjes së pesë guidave/pakove turistike të rajonit Jug, bashkëpunim i ngushtë me redaktorin e guidave/pakove turistike dhe fotografimin, komunikim i rregullt me komunat e rajonit Jug gjatë mbledhjes së të dhënave.

### *Kriteret e përzgjedhjes*

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve për këto pozita, EC Ma Ndryshe do të ketë për bazë këto kriteret e përzgjedhjes:

- Oferta financiare,
- Përvoja profesionale dhe dëshmitë dokumentare (portfolio për pozitën e fotografit),
- Niveli i edukimit formal,
- Shkathtësitë hulumtuese dhe të shkrimit (nuk vlejné për pozitën e fotografit)
- Referencat nga punëdhënësit (opsionale).

### *Aplikimi*

Për të aplikuar në njërin nga këto pozitat, ju lutem dërgoni CV-në tuaj në email adresën [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) dhe shkruani në *subject* "Aplikim për [titulli i pozitës]", më së largu deri më 29 Nëntor 2014, në orën 15.00. Aplikacionet që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen. CV-ja juaj, përveç tjerash duhet të përmbajë të dhëna mbi edukimin, përvojën profesionale, shkathtësitë (shkrim, hulumtim) dhe publikimet (mund të bashkëngjiten si dokumente të veçanta), ndërsa në email duhet të paraqitni edhe ofertën financiare për kryerjen e shërbimeve përkatëse (shuma për ditë të konsulencës ose shuma totale e angazhimit).

Pas vlerësimit fillestar të aplikimeve, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga aplikuesit nëse e vlerëson të nevojshme. Vetëm aplikuesit e përzgjedhur në listën e ngushtë do të njoftohen dhe do të kalojnë në procesin e intervistimit. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare për të gjitha pozitat e konsulencës. Për më shumë informacione rreth thirrjes për aplikim, ju lutemi vizitoni [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse).

*Projekti "Mbështetje për sektorin e turizmit në Rajonin Ekonomik Jug", përkrahjet financiarisht nga Ministria për Punëve të Jashtme të Finlandës në suaza të projektit "Ndihmë Tregtisë", implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*